



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 446/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Nenad Lazić dhe Xhevdet Abazi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e paraqitur nga Shqiponja Ponosheci kandidate për deputete për Kuvendin e Republikës së Kosovës nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), paraqitur kundër rezultatit përfundimtar të publikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, në seancën e panelit të mbajtur me 30.06.2014, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Shqiponja Ponosheci kandidate për deputete nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK).

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 27.06.2014, nga Shqiponja Ponosheci kandidate për deputete për Parlamentin e Republikës së Kosovës nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës, me të cilën pretendohet se në rezultatin përfundimtar të publikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), nuk i janë evidentuar të gjitha votat, me theks të veçantë në Komunën e Rahovecit, Gjakovës, Podujevës, Lipjanit dhe Prishtinës.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

ankesa është e pabazuar

PZAP-i konstatoi se pretendimet ankimore janë të përgjithshme dhe të pabazuara ngase parashtruesja e ankesës nuk e ka ofruar asnjë dëshmi për të vërtetuar se është bërë ndonjë parregullsi siç ka potencuar në ankesë, po ashtu nuk ka dhënë asnjë udhëzim apo hollësi se ku mund të gjenden dëshmitë të cilat nuk i ka pasur në posedim lidhur me atë çka pretendon në ankesë.

Prandaj PZAP-i në mungesë të provave dhe dëshmive konkrete dhe bindëse për pretendimet e paraqitura në ankesë konstaton se ankesa në fjalë është e pabazuar

dhe e pa argumentuar, andaj në kuptim të Nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën në fjalë vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 446/2014 më datën 30.06.2014



**Kryesuesi i Panelit
Muhamet Rexha**

Udhëzim Juridik:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*